

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësia Org.
Org. Jedinica
Org. Unit
Nr. i faqeve
Br. stranica
No. pages

Nr. Prot.
Broj Prot.
Prot. No.
Data:
Datum:
Date:

5
354
18.03.21
Prishtinë/a



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 09.09.2021
Nr. 5/354

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3, 4, 7 dhe nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe në bazë të kërkesës për rilicencim nga BPrAL- Kolegji “Riinvest” nr. 354 dt. 18.03.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL) – kolegji “RIINVEST” në Prishtinë, i vazhdohet licenca deri më: 30.09.2022.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, bazuar në kërkesën me dosjen e kolegjit “Riinvest” nr. prot. 354 dt. 18.03.2021, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, i ka udhëhequr procedurat e nevojshme administrative sipas, UA- nr. 25/2012 - Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Kolegji “RIINVEST” posedon vendimin me nr. 1350/19D dt. 29.07.2019 dhe vendimin me nr. 3033/21 dt. 12.08.2021 për akreditim institucional dhe të programeve nga AKA.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, komisioni konstaton se në mungesë të dokumentit që kërkohet sipas UA-25/2012, konkretisht nenit 7 pika 2 paragrafi 2.15 kolegji “RIINVEST” ka ofruar shkresën me nr. ref. 05-356-31472 datë 05.06.2020, të lëshuar nga drejtoria e urbanizmit sektori i urbanizmit se objekti është në procedurë të legalizimit si dhe një dokument – deklaratë

me shkrim me nr. 1049-2 dt 02.09.2021, përmes të cilës institucioni garanton për sigurinë e objektit- qendra Prishtinë dhe merr përsipër që të përfundojë procesin e legalizimit brenda vitit ose të ndërroj lokacion.

Komisioni në bazë të kësaj, vendosi që institucionit në fjalë, t'i jepet licenca në kohëzgjatje njëvjeçare.

Gjithashtu kolegji në fjalë ka ofruar disa dokumente shtesë ku njëra prej tyre është vendim nr.01-643 për lejin e ndërtimit me të cilin i lejohet pronarit "ERV" sh.p.k. me investitor "MARIGONA HILL" në lagjen Prishtina e Re-Zona Lindje.

Mirëpo, Kolegji "Riinvest" ka bërë kërkesë për licencim për objektin në rrugën "Lidhja e Prizrenit", nr. 48 në Prishtinë, me pronar Bashkim Osmani, Hamdije Osmani dhe Shehide Osmani, në të cilën zhvillohet veprimtaria arsimore, kërkimore-shkencore.

Prandaj, komisioni konstatoi se leja e ofruar e ndërtimit për objektin tjetër, nuk mund të merret për bazë sepse ka të bëjë me një objekt tjetër dhe jo për objektin për të cilin është kërkuar licencimi me rastin e parashtrimit të kërkesës për licencim, në MASHTI.

Për vazhdimin e licencës për vitin akademik 2022-2023, kolegji "RIINVEST" duhet të përmbush kriteret sipas UA-25/2012 dhe afateve të cekura në deklaratë.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të MASHTI-t;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Komisionit për licencim;
4. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
5. DALSH;
6. DNJBIA;
7. Inspektoratit të arsimit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit



Burim Gashi